



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MAT
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.____.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR, E THJESHTUAR – MALLRA”

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje mallrash dhe paisje për ndërtimin e ambienteve rekreative dhe struktura ekologjike turistike në kuadër të projektit me titull “*Menaxhimi i koordinuar për binomin mjedis-turizëm, potencial për zhvillim social dhe ekonomik në NJVV Mat*”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

43320000-2 – Pajisje ndërtimi, **44110000-4** - Materiale ndërtimi.

VLERA E FONDIT LIMIT:

8,554,800 (tetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind) **lekë pa TVSH**, nga buxheti i shtetit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c, dhe nenit 78 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor **Bashkia Mat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021**, **2022**, dhe **2023**, lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”**

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:
c) **40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme”.**

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë **40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.**”

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, vlerë kjo e kërkuar brenda masës së përcaktuar në dispozitat nënligjore të sipërcituara, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra

Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujtuar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar), në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për

të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Në nenin 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Në nenin 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4/b të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur ne DST. Fjala “kërkon” nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kriteret për furnizime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 40 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme në masën e përcaktuar në pikën 4/b të nenit 55.

2.3.2 Me qëllim vërtetimit e pajtueshmërisë së mallrave për të cilin do të ofertohej me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, për listën e mallrave/ pajisjeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- **Ekran LED**
- **Pompa zhytëse**
- **Rafte Metalike**
- **Kamera**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. **Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar**, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, dhe të jetë i vlefshëm vetëm për këtë objekt deri në realizimin e plotë të punimeve.
2. **Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve** për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, si dhe të plotësohen të dhënat sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i mallrave	Modeli i pajisjes	Emri i prodhuesit	Titujt e katalogeve, nr. faqes së katalogëve për çdo pajisje të ofruar, etj.	Faqja zyrtare e internetit e prodhuesit
-----	---------------------	-------------------	-------------------	--	---

Shënim: *Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.*

3. Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të certifikuar me ISO 9001 (*Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë*)/ ekuivalente dhe e vlefshme.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë **ISO 9001**, e cila duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe objekti i saj të përputhet me objektin e prokurimit. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të

konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, ISO-t duhen plotësuar nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/a**, dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar), në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;...”

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në **nenin 40 pika 2, 3 dhe 6/ c** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:...

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Gjithashtu në **nenin 44** “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt

prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

1. Njësia e prokurimit bazuar në natyrën e mallrave objekt prokurimi që kërkohet të furnizohet, duke qënë se disa prej mallrave objekt prokurimi duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.
2. Gjithashtu, në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, njësia e prokurimit gjykon se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së mallrave/ produkteve objekt prokurimi në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së mallrave që kërkohet të kryhet furnizimi i tyre, njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatën e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto mallra/ materiale/ pajisje (ka të bëjë me parimet e produkteve, duke filluar nga faza e projektimit, prodhimit dhe shitjes së produktit/ materilialit) duke i dhënë besimin e plotësimin të kërkesave të cilësisë për mallin/ produktin blerësit (Autoritetit Kontraktor).

Njësia e prokurimit përcaktoj kriterin për kapacitetin profesional e teknik si më lart duke qënë se ky kriter është i detyrueshëm, është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha i shërben autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

- 2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar pjesë të stafit punonjës për kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi, të vërtetuar me kontratë pune (e vlefshme), diplomë/ çertifikatën

përkatëse, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listëpagesën e shoqërisë për periudhën, 3 (tre) muajt e fundit, stafi i specialistëve të diplomuar/ certifikuar, si më poshtë:

- Minimumi **1 (një) inxhinier** Elektronik/ Telekomunikacioni;
- Minimumi **2 (dy) punonjës** të certifikuar nga prodhuesi i sistemit të kamerave të ofertuar;
- Minimumi **2 (dy) punonjës** të certifikuar nga prodhuesi i ekranit LED (led wall)

Shënim: AK lejon faktin që 1 (një) inxhinier/ punonjës të ketë më shumë se një certifikim të kërkuar.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** pika **1** dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. **4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”**

Në **nenin 40** “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika **5** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:...**

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur ne DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Me qëllim instalimin dhe vënien në funksion të pajisjeve elektronike dhe sistemit të kamerave objekt prokurimi në përputhje me specifikimet teknike, cilësinë dhe standartet e miratuara, njësitë e prokurimit ka kërkuar inxhinier/ specialistë të certifikuar për vërtetimin se operatorët ekonomikë disponojnë stafin kryesor të nevojshëm për kryerjen e këtyre shërbimeve, ku më hollësisht:

- Është kërkuar minimumi **1 (një) inxhinier** Elektronik/ Telekomunikacioni, pasi në kontratën objekt prokurimi kemi të bëjmë me *vendosjen e sistemit të kamerave* në Njësitë administrative të Bashkisë Mat, si dhe *montimin e ekranit LED*, ku montimi i tyre duhet të kryhet dhe kontrollohet nga inxhinieri me profilin përkatës, me qëllim garantimin e funksionimit me sukses të këtyre pajisjeve elektronike.
- Janë kërkuar minimumi **2 (dy) punonjës** të certifikuar nga prodhuesi i sistemit të kamerave të ofertuar, me qëllim instalimin dhe vënien në funksion të sistemit të kamerave në njësitë administrative të Bashkisë Mat.
- Janë kërkuar minimumi **2 (dy) punonjës** të certifikuar nga prodhuesi i ekranit LED (led ëall), me qëllim instalimin dhe vënien në funksion të ekranit LED (led ëall), të cilët duhet të jenë të certifikuar nga prodhuesi i ekranit, me qëllim vërtetimin e aftësisë profesionale dhe disponimit të kualifikimeve të nevojshme teknike për montimin dhe vënien në funksion të ekranit i cili do të ofertohej.

Stafi i specialistëve të kërkuar i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur duhet të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi **2 (dy) automjete ATP** (*automjet i transportit të përzier*) me kapacitet mbajtës jo më pak se 1.5 ton, të cilët duhet t'i ketë në pronësi ose me qira, dhe për të cilët duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, që vërteton Rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (të vlefshme), Siguracionin e mjetit (të vlefshme), Çertifikate për transport mallrash dhe Taksat e paguara. Në rast se automjeti disponohet me qira, duhet të paraqitet dhe kontrata përkatëse e qerasë, në emër të subjektit, të lidhura para noterit dhe afati i të cilave të përfshijë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Disponimi i automjeteve do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë garancie, që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së pajisjeve elektrike, elektronike dhe elektromekanike, si: ***Gurë fresibël, Motorsharrë shine, Pompa zhytëse, Motorr i gomones për shpëtim, Kamera, dhe Ekran Led Outdoor Full Color***, për një periudhë jo më pak se **12 (dymbëdhjetë) muaj** nga data e dorëzimit të secilit mall pranë autoritetit kontraktor.
- 2.3.7 Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë një **vetëdeklarim** që merr përsipër montimin, instalimin dhe vënien në funksion të mallrave objekt prokurimi: ***Kamera, dhe Ekran Led Outdoor Full Color*** në vendndodhjet që do të përcaktohet nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) ***aftësinë teknike dhe profesionale.***

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe **aftësitë teknike e profesionale** për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.***

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”*

Në **nenin 40** “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 5 dhe 8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. ***Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:...***

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, njësia e prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se, edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t’u

vendosur ne DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë numrin automjeteve të kërkuara të përshtatshëm për transport mallrash, **të cilat janë të nevojshme për kryerjen e transportit të mallrave/ pajisjeve objekt prokurimi në vendodhjen e përcaktuar nga autoriteti kontraktor**, ku sasia dhe peshëmbajtja e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën, specifikat, dhe përmasat e mallrave objekt prokurimi, pasi një mjet me tonazh më të vogël (*ku rrjedhimisht dhe hapësira që ka*) nuk mund të kryejë transportin e të gjithë mallit që do të kërkohet sipas kontratave që do të nënshkruhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, kjo referuar dhe praktikave të mëparshme, ku furnizimi i tyre është kryer me automjete me tonazh peshëmbajtje më të lartë se ajo e kërkuar, pasi në rast se furnizimi kryhet me mjete me tonazh më të vogël, kemi rritjen e kostove të rrugëve që do të kryejë, angazhimin e punonjësve të transportit dhe montimit, ku rrjedhimisht do të kemi vonesa dhe në kryerjen e furnizimit në kohëzgjatjen e përcaktuar të kontratës. Njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin operatorët ekonomik pjesëmarrës me qëllim vërtetimin e disponimit të tyre, dhe dokumentacionin tekniko-ligjor të tyre të cilat duhet të regjistrohen në regjistrat publik për qarkullimin e tyre. **Njësia vlerëson se pa këto mjete transporti një operator ekonomik nuk mund të realizoj furnizimin e mallrave të parashikuar në këtë kontratë objekt prokurim.**
2. Duke qënë se në përlllogaritjen e çmimit të mallrave objekt prokurimi është përfshirë dhe shërbimi i instalimit të tyre, njësia e prokurimit e vlerëson të domosdoeshëm faktin që, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet detyrimisht të deklarojnë se marrin përsipër kryerjen e transportit, montimit, instalimit dhe vënien në funksion të disa prej mallrave/ pajisjeve objekt prokurimi në vendndodhjet që do të përcaktohen nga Autoriteti Kontraktor, **për të përjashtuar mundësinë që kontraktuesi të pretendojë se një shërbim i tillë nuk është kërkuar në dokumentat e tenderit**, ku A.K. do t'i duhet që të paguajë kosto shtesë për transportin, montimin dhe instalimin e tyre si dhe kjo shërben dhe në lidhje me garancinë e këtyre pajisjeve, **duke shmangur pretendimin e mosmbajtjes së garancisë së defekteve brenda periudhës së kërkuar për shkak të gabimeve në instalimin e tyre.**
3. Po ashtu, njësia e prokurimit referuar specifikës që kanë mallrat/ pajisjet elektrike/ elektronike dhe elektromekanike objekt prokurimi, vendosi që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një **deklaratë garancie** që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së këtyre mallrave/ pajisjeve për një periudhë jo më pak se **12 muaj** nga data e dorëzimit të mallit pranë autoritetit kontraktor, pasi mund të gjendemi përpara rastit ku këto pajisje mund të jenë të një cilësie të dobët, të kenë defekte fabrikimi etj., ku O.E. duhet të jetë i gatshëm për zëvendësimin e tyre, **gjë që i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e reputacionit dhe besueshmërisë të**

operatorëve ekonomikë se marrin përsipër të kryejnë furnizime të pajisjeve cilësore të kërkuar.

Automjetet dhe deklaratat e kërkuar i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithëcka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.8 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor **një mostër për:**

- Tub për luftim zjarri me koke 50 mm
 - Mbrojtëse frymëmarrje
 - Pllakë Ekрани LED
 - Kamera
 - Jelek shpëtimi Reef life jet
- **Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje/material të kërkuar ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike e përcaktuara në DST, përbën kusht për s'kualifikim.**

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) ***aftësinë teknike dhe profesionale.*** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se ***operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike***, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. ***Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*** 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 40 pika 2, 3 dhe 6 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose...

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, duke qënë se disa prej mallrave objekt prokurimi kanë rëndësi në lidhje me materialin nga i cili përbëhet/ prodhohet, dhe cilësinë që duhet të kenë, njësia e prokurimit e vlerëson të rëndësishëm kushtin e paraqitjes së mostrave për mallrat objekt prokurimi ditën e hapjes së ofertave, **me qëllim që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të ketë mundësinë për të kontrolluar nëse mallrat/ pajisjet objekt kontrate që do të furnizohen, janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit.**

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s’kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se operatorët ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në shkresën **Nr.Prot.4115, datë 25.10.2024** “Kërkesë për objektin: “Blerje mallrash dhe paisje për ndërtimin e ambienteve rekreative dhe struktura ekologjike turistike në kuadër të projektit me titull “Menaxhimi i koordinuar për binomin mjedis-turizëm, potencial për zhvillim social dhe ekonomik në NJVV Mat” dërguar nga Drejtoria e Shërbimeve Bashkiake/ Bashkia Mat, ku bashkëlidhur ka dërguar specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi, duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik¹” (i ndryshuar), dhe nenin 40 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për mallrat/ produktet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 25.11.2024, ora 11.00, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al** .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT